URDHËR
Nr. 351, datë 29.5.2020

PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA DHE KUFIZIMEVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË COVID-19

(Ndryshuar me urdhrin nr. 351/1, datë 22.6.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Lejohet lëvizja në të gjithë vendin për të gjithë kategoritë (këmbësorë, biçikleta ciklomotorë dhe mjete) pa kufizim orari. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm për datat 30–31 maj 2020, ku ndalohet vetëm lëvizja nga zonat e kuqe në zonat jeshile dhe anasjelltas.

2. Lejohet të kryejnë veprimtarinë e tyre të gjithë aktivitetet e nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike, duke respektuar protokollet e sigurisë dhe rregullat e miratuara për distancimin social dhe masat higjeno-sanitare.

3. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 2, të këtij urdhri, bëhet për aktivitetet e mëposhtme:

a) klubet e natës;

b) aktivitetet kulturore, teatro, kinematë;

c) pishina.

4. Ndalohen grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore deri në një urdhër të dytë.

5. Hapen parqet dhe zonat e gjelbra, duke filluar nga data 1.6.2020.

6. Hapen kurset e formimit profesional, edukativ dhe argëtues, këndet e lojërave për fëmijë në ambientet e hapura, palestrat, qendrat e internetit, sipas protokolleve të miratuara dhe rregullat e miratuara për distancimin social dhe masat higjeno-sanitare, duke filluar data 1.6.2020.

7. Lejohet kryerja e konkurseve për punësim të personelit, konkurseve të shkollimit dhe specializimit, duke filluar data 1.6.2020, sipas protokolleve të miratuara dhe rregullat e miratuara për distancimin social dhe masat higjieno-sanitare.

8. Hapen plazhet vetëm për strukturat akomoduese nga data 1.6.2020. Plazhet publike do të hapen në datën 6.6.2020, duke respektuar protokollet e miratuara dhe rregullat për distancimin social dhe masat higjeno-sanitare.

9. Lejohet lëvizja me mjetet e trasportit për udhëtarët në hyrje dhe në dalje në pikat e kalimit kufitar tokësor. Personat që do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në pikat kufitare tokësore nuk do të kenë detyrimin e vetëkarantinimit 14-ditor, me përjashtim të rasteve të veçanta, që do të përcaktohen me urdhër të autoriteteve shëndetësore.

10. Shfuqizuar.

11.Çdo parashikim tjetër që bie në kundërshtim më këtë urdhër, shfuqizohet.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu